

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|---------------------------------------|------------|-------------------|-------------------|
| Premier - Priftina LINDON, 16.02.2023 | | | |
| Nr. i organit Org broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02- | 035 | /02- | 130 |

| | |
|---|--------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRASNIH POSLOVA MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS | |
| AGJENCIA PËR MENAXHIMIN EMERGJENT AGENCIJA UPRAVLJANJA VANREDNIM SITUACIJAMA EMERGENCY MANAGEMENT AGENCY | |
| Nr. Br. No. | Nr. Br. Br. No. pg |
| 17 | 5 |
| Data/Date: 15.02.2023 PRISHTINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs
Agjencia e Menaxhimit Emergjent / Agencija Emergentnog Upravljanja/
Emergency Management Agency

Prishtinë, 15/02/2023

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

NDËRMJET

AGJENCISË SË MENAXHIMIT EMERGJENT - MINISTRIA E PUNËVE TË
BRENDSHME

DHE

KOMUNËS SË VITISË PËR

BASHKËFINANCIM DHE REALIZIM TË "FAZËS FINALE TË PUNIMEVE NË
NDËRTIMIN E OBJKTIT PËR NJPZSH -VITI"

Agjencia e Menaxhimit Emergjent- Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "AME/MPB"), rruga "Dëshmoret e Gollakut " pn. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, në njërën anë dhe

Komuna e Vitisë, e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Komuna"), rruga "28 Nëntori pn Viti, Republika e Kosovës, në anën tjetër.

Në tekstin vijues të referuara bashkërisht si "Palët" janë pajtuar si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit "Fazës e finale e Punimeve ne Ndërtimin e objektit për NJPZSH -Viti" si dhe përcaktimi i obligimeve të AME-së dhe Komunës së Vitisë, për realizimin e këtij projekti.

Neni 2 Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Projekti "Fazës finale të Punimeve ne Ndërtimin e objektit për NJPZSH -Viti" ka vlerën para llogaritave prej 176,142.75 €.
2. AME nga buxheti i saj vjetor i vitit 2023, financon këtë projekt në shumën prej 76,000.00 € apo shprehur ne përqindje 43.15% e projektit .
3. Komuna e Vitisë nga buxheti i saj vjetor i vitit 2023, financon këtë projekt në shumën prej 100,142.75 € apo shprehur ne përqindje 56.85% e projektit.
4. Pagesat do te realizohen sipas %(përqindjes se financimit) te cekur ne nenin 2 dhe 3.

Neni 3 Obligimet e Agjencisë se Menaxhimit Emergjent

1. AME -ja i zoton mjetet për projektin nga neni 2 paragrafi 2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
2. Pagesat për projektin "Fazës finale të Punimeve në Ndërtimin e objektit për NJPZSH - Viti" nga AME, do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve sipas kushteve të kontratës, në rastin e bashkëfinancimit të projektit pagesat e para behën nga mjetet e zotuarra të buxhetit të AME-se.
3. Komuna me rastin e formimit të Komisionit për procedurat e prokurimit dhe tenderimit duhet të kërkoj nga AME një përfaqësues si anëtar komisioni, anëtar i cili duhet të marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve dhe në procesin e vlerësimit të tenderëve.
4. AME-ja monitoron këtë projekt në të gjitha fazat. Monitorimi bëhet përmes Operatorit Ekonomik- OE të cilën AME-ja e kontraktton pa e përjashtuar edhe mundësinë e monitorimit

të përbashkët (Zyrtar i AME-se - OE) dhe në rast se vërejnë parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës njoftojn menaxhmentin.

Neni 4 Obligimet e Komunës

1. Komuna është e obliguar që pas pranimin të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar dhe të protokolluar të hartoj projektin zbatues si dhe të siguroj tërë dokumentacionin e nevojshëm që projekti nuk do të ketë pengesa në realizim.
2. Komuna obligohet të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së paralogaritur të projektit, dhe një kopje ta dërgoj në AME.
3. Komuna i zotën mjetet për projektin nga neni 2 paragrafi 3 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në AME.
4. Komuna obligohet që projektin ta zhvilloi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik të Kosovës, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-237, Ligjin Nr. 05/l-068, Ligjin Nr. 05/l-092 dhe Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet nënligjore.
5. Komuna është bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit sipas ligjit në fuqi. Procedurat e prokurimit, komuna duhet t'i filloj brenda 30 dite kalendrike pas nënshkrimit Marrëveshjes në të kundërtën AME në mënyrë të një anshme mund të ndërpres marrëveshjen.
6. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me OE të sjellë një kopje të kontratës identike me origjinalin në AME së bashku me informatat për biznesin me qëllim të sigurimit të nxjerrjes së urdhër blerjes (numrin e biznesit dhe numri i llogarisë bankare).
7. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe bën inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.
8. Projekt menaxheri/organin mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës dhe sipas përqindjes së financimit të cekur në neni 2 pika 2 dhe 3.
9. Komuna obligohet që të njoftoj AME-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, ndërsa për punime shtesë që mund të dalin gjatë punimeve nga OE do të jenë obligim i Komunës .
10. Komuna duhet të vendos tabelën informuese (Panon) standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik në vend punishte.
11. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundoj gjatë vitit buxhetor 2023. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.
12. Komuna është e obliguar të njoftoj AME -në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas dinamikës së punimeve deri në përfundim të projektit.

13. Komuna obligohet që pas përfundimit të projektit, obligimeve kontraktuale të dërgoj në AME dokumentacionin përkatës me të cilin dëshmohet përmbyllja e projektit.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Komuna obligohet që për t'i realizuar pagesat për punët e kryera deri në shumën e financimit nga ana e AME -së, të kompletoj dokumentacionin si në vijim:

- 1.1 Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës;
- 1.2 Kopjen e deklaratës të disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së parallogaritur të projektit;
- 1.3 Vendimi për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e Komunës;
- 1.4 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët e kryera dhe të aprovuara (situacionet);
- 1.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar deri në shumën e financuar sipas përqindjes së financimit nga AME duke ju referuar nenit 2 pika 2 dhe 3;
- 1.6 Sigurimin e ekzekutimit, garanacionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës;
- 1.7 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

Neni 6

Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kalojë në pronësi të AME-se.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të AME-se në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 7

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

